

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

Nr./Br. 333 91/26
Nr. i fq./Br. st. - 4 -
Data:/Datum: 27.07.2026

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 116/26, 27.07.2026

PROCESVERBAL

nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23 qershor 2026 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Xhon Gubetini, Kushtrim Hyseni, Blerina Shala, Fatmire Cecelia, Ymer Haradinaj dhe Gentiana Rama (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 26.05.2026;
2. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2027-2029;
3. Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2025;
4. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 294/19, të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 26.05.2026.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 26.05.2026.

2. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2027-2029.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – deklaroi se barra kryesore për këtë i bie Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – ky është një dokument bazik, i cili vjen nga Ministria e Financave dhe është obligim i komunave që brenda një afati të caktuar ta implementojnë. Siç po shihet nga ky dokument të burimet e financimit komunal 20027-2029, shohim që komunat pranojnë grante operative nga buxheti i Republikës së Kosovës: granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim, granti specifik për shëndetësi. Ai tha se e ka bërë një krahasim me vitin e kaluar, ku është miratuar një buxhet, por që ka qenë diçka tjetër i planifikuar, kurse diçka tjetër është punuar. Te granti i përgjithshëm, shihet që investimi nga qeveria qendrore ka rritje, për vitin 2026 - 12,210,626€, për vitin 2027- 13,366,922€, për vitin 2028 - 14,375,842€ dhe për vitin 2029 - 15,508,304€.

Ajo çka na takon neve si anëtarë të KPF-së janë dëgjimet publike me qytetarë. Prandaj, kisha kërkuar nga drejtoria kompetente, por edhe nga komuna e Vushtrrisë që prioritetet të cilat caktohen nëpër takime, pra kërkesat që merren nga qytetarët të caktohen si prioritet, e jo qytetarët po kërkojnë diçka tjetër, kurse ato ose nuk po realizohen ose po devijohen ato projekte. Po ashtu, kërkoj nga Drejtoria e Financave, që për takimet buxhetore t'i kemi të gjitha projektet që kanë filluar edhe kanë me u punuar këtë vit edhe vitin e ardhshëm. Kjo për shkak se, ne si anëtarë të kuvendit të kemi çka t'ju themi qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Ajo që e pashë nga draft-kalendari kohor ishte se numri i takimeve ishte rritur nëpër fshatra dhe qytet nga vitet e kaluara, kurse e dimë që numri i anëtarëve të KPF-së dhe i banorëve është zvogëluar. Pra, në mandatin e kaluar KPF-ja i ka pasur 9 anëtarë, tani i ka 7 dhe në proporcion me këtë është dashur të zvogëlohet numri i takimeve.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – në bazë të qarkores buxhetore merren kufijtë final buxhetor të grantit të përgjithshëm, atij specifik të arsimit dhe grantit të shëndetësisë dhe të hyrave vetanake. Jemi të obliguar që të pasqyrojmë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, si dokument strategjik me projeksione për dy vitet e ardhshme. Ne mund t'i ndryshojmë kategoritë ekonomike deri kur të miratohet buxheti në muajin shtator, psh. me i zvogëluar investimet kapitale e me i rrit mallrat dhe shërbimet, ose me i zvogëlu mallrat dhe shërbimet e me i rrit subvencionet.

Ju e dini që vendimet gjyqësore dhe përmbarimore të Kontratës Kolektive e kanë devijuar planin buxhetor. Në të gjitha projektet trivjeçare kemi ngecje. Tash e kemi problem edhe të dalim në dëgjime buxhetore, sepse si propozim i drejtorisë do të vjen që 50% të investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve të planifikohen për kodin ekonomik 004 – për vendimet gjyqësore. Komuna jonë i ka afër pagesat e këtyre vendimeve, kurse komunat tjera janë në falimentim e sipër.

Nëse Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i mbulon këto obligime, të gjitha komunat do të falimentojnë.

Lidhur me atë që anëtarët e KPF-së të pajisen me dokumentacion për dëgjimet buxhetore, ai tha se do t'ua japin materialet e nevojshme, duke përfshirë të gjitha kontratat dyvjeçare të nënshkruara. Disa projekte siç do ta shihni as nuk kanë filluar, sipas pasojë e vendimeve gjyqësore që u cek më lartë. Meqenëse projektet nuk kanë filluar, kontrata është nënshkruar, ne jemi të obliguar që punët të kryhen dhe të realizohen. Por, për projekta të reja, është fat i mirë që projeksioni i të hyrave është edhe për dy vitet e ardhshme. Prandaj, bashkërisht duhet t'i analizojmë dhe kërkesat që janë më emergjente duhet të futen në tabelat buxhetore, kurse ju jeni ata që vendosni për aprovimin e buxhetit në shtator.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – sa i përket numrit të takimeve për dëgjime buxhetore, në mandatin e kaluar kemi mbajtur trajnime për dëgjime buxhetore dhe nuk do të thotë që të vjen numër i madh i njerëzve në këto takime, por e rëndësishme është që ne të jemi pranë qytetarëve. E di që jemi numër më i vogël i anëtarëve të KPF-së, e di që do të na del punë më shumë kësaj radhe, por më mirë të jemi

më afër qytetarëve. Mendoj që vitin e ardhshëm, dikush prej neve si anëtarë të KPF-së të shkojmë dhe të bisedojmë me kategori të ndryshme si: personat me nevoja të veçanta në Handikos, apo me gratë në viset rurale, dhe me kategori tjera.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – rregullimi i lumit “Silnica” nga shtrati i lumit “Podrança” deri te shkarkimi i lumit në Smrekonicë. Drejtor, nëse edhe një herë thua që s’keni buxhet, dilni shumë qesharak. Me këtë projekt keni kërkuar 10 eskavator 23 ton, keni kërkuar cilindër me dhëmbëza 19 ton, është kërkuar makineri 400 ton, eskavator merimangë – minimumi 5 ton. Kush i ka parë specifikat e këtij tenderi e din krejt se kujt ja keni hapur këtë tender. Pasi që po thuani s’ka mjete financiare, pse është hapur ky tender me vlerë milionëshe? Në këtë mënyrë po e fusni komunën në obligime dhe kushdo që e fiton pushtetin në mandatin e ardhshëm do të ballafaqohet me këto borxhe.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – kërkoi nga anëtarët që të përcaktohen se ku dëshirojnë t’i udhëheqin takimet publike me qytetarë.

KPF-ja njëzëri vendosi se cilët anëtarë do t’i udhëheqin takimet publike me qytetarë (dëgjimet buxhetore, kurse do ju dërgohet anëtarëve të kuvendit se ku dëshirojnë ata që të marrin pjesë.

Stroc – Gentiana Rama; Druar – Ymer Haradinaj; Novolan – Melihate Basholli Latifi; Duboc – Kushtrim Hyseni; Pantinë – Blerina Shala; Smrekonicë – Blerina Shala; Samadrexhë - Melihate Basholli Latifi; Maxhunaj – Fatmire Cecelia; Nedakoc – Xhon Gubetini; Stanoc i Epërm – Ymer Haradinaj; Stanoc i Poshtëm – Ymer Haradinaj; Prelluzhë – Ymer Haradinaj; Dumnicë e Llugës – Gentiana Rama; Gojbulë – Kushtrim Hyseni; Studime e Epërme – Kushtrim Hyseni; Me grupet e ndryshme të grave – Melihate Basholli Latifi; Me sportistë, rini dhe komunitetin artistik – Fatmire Cecelia; Me biznese dhe fermerë – Xhon Gubetini; Me banorët e qytetit – Të gjithë anëtarët e KPF-së.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2025.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – kjo informatë është shumë e mangët, na kanë ardhur vetëm numri i kërkesave që kanë aplikuar për legalizim në Drejtorinë për Urbanizëm. A po i bie kjo që ndërtoni sa të mundeni pa leje, pastaj vjen një kampanjë për legalizim të atyre objekteve. Për mendimin tim ky proces i legalizimit është dështim edhe i ministrisë që e ka nxjerr udhëzimin administrativ për legalizimin e objekteve pa leje. Komunitat duhet të diskutojnë me minitrinë që ta shfuqizojë këtë udhëzim ose të ketë një afat ligjor deri në cilin vit të bëhet legalizimi.

Bedri Dobra, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se kjo pikë është e Drejtorisë së Urbanizmit, por ndërlidhet me drejtorinë tonë. Ai tha se çdo objekt që është ndërtuar deri në vitin 2018 dhe gjendet në ortofoto, kur është bërë aerofotografimi dhe që i plotëson kriteret do të legalizohet. Objektet e ndërtuara pa leje pas vitit 2018 nuk do të legalizohen.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – një informatë e mangët për një proces kaq të rëndësishëm. Është dashur të bëhet një kampanjë që të njoftohen qytetarët për procesin e

legalizimit, sepse numri i objekteve është shumë më i madh në raport me kërkesat e aplikimit.

Cilat janë objektet e kategorisë së parë dhe të dytë?

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 294/19, të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – kjo pronë gjendet në zonën kadastrale të Gracës dhe si projekt ka qenë që të ndërtohet një fabrikë e peshkut. Edhe atëherë kemi qenë skeptik se do të ndërtohet një fabrikë e tillë. Por, për vetë faktin që pronarët patën ardhur nga Kroacia e Spanja në sallën e kuvendit dhe patën paraqitur projektin e tyre, kuvendi ua pat dhënë në shfrytëzim këtë pronë. Pas kësaj ndryshoi gjeopolitika, u paraqit pandemia Covid 19, po ashtu lufta Rusi-Ukrainë dhe si pasojë e këtyre na është thënë që ky projekt ka dështuar. Si anëtarë të një komisioni që kemi qenë në mandatin e kaluar: Unë, Bekim Zabërgja, Zojë Hajrizi e Agron Përçuku, jemi takuar zyrtarisht (kemi edhe procesverbal) me përfaqësues të Interex-it dhe kompanisë, e cila ka pasur që ta bëjë investimin. Përfaqësuesit e Interex-it dhe kompanisë na kanë thënë që projekti ka dështuar dhe jemi dakorduar që as komuna mos ti padis ata për dështimin dhe as ata mos ta padisin komunën për atë që nuk iu është ofruar. E mbështesim që këtë propozim që prona t'i kthehet komunës dhe mendoj që edhe më herët është dashur të ndodhë kjo. Si është gjendja e asaj prone sot?

Bedri Dobra, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se kadastrë dhe pronat në Kosovë ballafaqohen me probleme të mëdha, për shkak të mungesës së dokumentacionit. Por, e kam marrë seriozisht punën e pronave komunale, ku kemi filluar ta freskojmë databazën për identifikimin e të gjitha pronave komunale. Këtë pronë e kanë vizituar zyrtarët e kadastrit, prona është e pastër sa i përket dokumentacionit, një pjesë e kësaj prone është e lavruar nga uzurpatorë të ndryshëm.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – këtë pronë e kam vizituar edhe unë para katër dite. Kësaj prone ju ka rrit vlera, sepse është ndërtuar një asfalt afër saj deri te varrezat. Në këtë pronë, afër 20 ari janë disa varreza. Pasi që prona t'i kthehet komunës, duhet t'i zyrtarizojmë ato varreza, sepse është kërkesë e banorëve që jetojnë aty afër.

Bedri Dobra, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – pasi prona t'i kthehet komunës, duhet të sillen në kuvend që ajo pjesë e pronës po bëhet varreza, krijohet parcela e re dhe mund të rregullohet.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës



Melinate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe KPF- së